



Të reja ▾Kush jemi ▾HistorikuShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjetVideoProgrami i transparencës ▾Kontakt

Denonco Krimin Kibernetik ▾Drejtoritë Vendore ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾DonacionePolicimi në Komunitet ▾

Përmbledhja Mujore ▾Për sinjalizimin ▾Të Guximshëm pa Armë

Breaking News:

Berat/Shiste doza Kokaine, ndërkohë që ishte në hetim për të njëjtën vepër penale, vihet në pranga 48-vjeçari

⏏ ⏪ ⏩



03/07/2025

Durrës/Dyshohet Se I Morën Një Shumë Parash Një Shtetasi, Duke E Kanosur Me Armë Zjarri, Identifikohen 4 Shtetas

Durrës

Dyshohet se i morën një shumë parash një shtetasi, duke e kanosur me armë zjarri, identifikohen 4 shtetas. Vihet në pranga njëri prej tyre, punohet për kapjen e 3 të tjerëve.

Specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisarariatit të Policisë Durrës, në bashkëpunim me Seksionin e Hetimit të Krimeve ndaj Personit në DVP Durrës, menjëherë pas kallëzimit nga shtetasi A. I., se dje, në lagjen nr.13, Durrës, 3 shtetas i kishin marrë 150.000 lekë, duke e kanosur me armë zjarri, kanë kryer veprimet hetimore për të identifikuar autorët dhe për të zbardhur rrethanat e rastit.

Si rezultat i veprimeve të shpejta, u kap dhe u vu në pranga njëri nga autorët e dyshuar të rastit, shtetasi A. L., 40 vjeç, banues në Durrës, dhe u shpallën në kërkim 3 të tjerët, shtetasit R. I., 40 vjeç, L. I., 20 vjeç dhe E. M., 34 vjeç, të tre banues në Durrës.

Vijon puna për kapjen e 3 shtetasve të shpallur në kërkim dhe për dokumentimin e rrethanave të këtij rasti.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për veprime të mëtejshme.

◀ Pogradeç/Finalizohet operacioni policor i koduar “Buçimasi”

Berat/Shiste doza Kokaine, ndërkohë që ishte në hetim për të njëjtën vepër penale, vihet në pranga 48-vjeçari ▶

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

> Arkiva

> Akademia e Sigurisë

> Ministria e Brendshme

> Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

> Interpol

> Europol

> Misioni PAMECA V

> SCPA

> Projekti Trivalent